



**Republika e Kosovës**



**Komuna Vushtrri**

---

**DREJTORIA PËR KULTURË, RINI E SPORT**

**PLANI I PUNËS PËR VITIN 2012**

**Vushtrri, nëntor 29, 2012**

**Drejtori i DKRS  
Qamil Sahiti**

## Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport janë këta sektorë:

### **1. Sektori për Kulturë**

- Qendra e Kulturës “ Hasan Prishtina “ – Vushtrri,
  - Ansambli i Këngëve dhe Valleve,
  - Teatri
- Biblioteka,
- Arkiva,
- Muzeu,
- Trashëgimia Kulturore

### **2. Sektori për Rini**

### **3. Sektori për Sport**

- Klubet dhe Shoqatat Sportive,
- Objektet Sportive.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

**Në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina “** do të vazhdojnë punët e përditshme në mirëmbajtjen e hapësirave të objektit.

Angazhimi i tërë stafit punues në të gjitha organizimet kulturore si:

- Organizimi i të gjitha festave shtetërore e kombëtare,
  - Harmonizimi i përgatitjeve për drejtoritë komunale,
  - Përgatitja e hapësirës dhe skenografisë,
  - Përgatitja e skenarit,
  - Përgatitja dhe realizimi komplet i programit artistik,etj.
- Shënimi i të gjitha datave përkujtimore,
- Përgatitjet e vazhdueshme ditore artistike,
- Organizimi i manifestimit “ Takimet e Poeteshave “,
- Organizimi special për 28 Nëntorin, Ditën e Flamurit,etj.

**Ansambli i Këngëve dhe Valleve “ Hasan Prishtina “** do të vazhdojë me përgatitjet e përditshme në mënyrë që të jetë i gatshëm në çdo kohë për performancë. Do të krijohen mundësi të reja për angazhim më të madh të të rinjve dhe profesionistëve në aktivitetin e ansamblit.

Ansambli do të përgatisë në minimum dy premiera.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

**Teatri i Qytetit** do të angazhohet për përgatitjen e shfaqjeve, skeçeve dhe mishërim në programet e ndryshme gjatë vitit si moderator, interpretues dhe inskenim mbështetës të pamjeve të ndryshme artistike. Gjithashtu do të bëhet një angazhim shtesë për dhënien e mundësisë për angazhim të aktorëve të rinj.

Teatri do të përgatisë në minimum dy premiera.

**Biblioteka “ Naim Frashëri “** ka një fond jo të mjaftueshëm të librave, sidomos atyre shkollore e shkencore. Do të pasurohet ky fond i librave me anë të investimit dhe bashkëpunimit me qendrat e tjera bibliotekare të Kosovës.

Gjatë vitit 2012 do të organizohen takime me nxënës dhe qytetarë, që për qëllim do të kenë ofrimin me lexuesin dhe nxitjen për sjelljen e investimeve në pasurimin e fondit të librit.

Gjithashtu biblioteka do të organizojë aktivitete të ndryshme si:

- Ekspozita me poezi për fëmijë,
- Ekspozita me punime letrare,
- 

Do t`i kushtohet rëndësi e veçantë promovimeve të reja të librit.

**Arkivin Historik Komunal.** Arkivi do të vazhdojë punën në rregullimin e hapësirës për punë. Do të bëhet pastrimi i dokumentacionit nga pluhuri si dhe do të bëhet sistematizimi i dokumenteve sipas rëndësisë. Në vitin 2012 do të fillojë edhe digjitalizimi i dokumentacionit me rëndësi. Gjatë vitit 2012 do të bartet dokumentacioni i komunës në arkiv.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

**Muzeu Etnografik** do të vazhdojë të mbledhë të dhëna për trashëgiminë kulturore në të gjitha kategoritë:

- Të luajtshme,
- Të paluajtshme,
- Shpirtërore, etj.

Gjatë vitit 2012 Muzeu do të organizojë në minimum dy premiera në paraqitjen e trashëgimisë.

**Spektori i Rinisë** do të jetë sektori që në vitin 2012 do të jetë një ndër sektorët më aktiv në Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport.

Në këtë sektor parashihet një numër i madh i aktiviteteve rinore në qytet e fshat. Krijimi i kushteve për angazhim të rinisë është objektiv i këtij sektori. Fillimisht me plan parashihen debate e tryeza për tema që kanë të bëjnë me rininë. Më pas investimi në aktivitete rinore në të mirë të rinisë dhe gjithë popullatës siç janë aktivitetet për vetëdijësim, aktivitetet kulturore e sportive, etj.

Do të fillojë investimi në bashkësi lokale për zhvillimin e aktiviteteve të lira rinore, sidomos atyre sportive me shuma të vogla në fusha basketbolli dhe volejbolli.

Rinia do të jetë e angazhuar në të gjitha aktivitetet kulturore e sportive të organizuara nga DKRS.

Në **Sektorin e Sportit** do të bëhet një angazhim më i madh në krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e gjithanshëm.

Gjithashtu edhe aktivizimi i hapësirave të ndryshme për shfrytëzim nga klubet dhe shoqatat sportive është objektiv i vitit 2012.

Përkrahja dhe organizimi i ngjarjeve të ndryshme sportive në bashkëpunim me të gjithë faktorët relevant.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport do të vazhdojë me intensitet të shtuar punën për investim në hulumtim arkeologjik, arkitektural, studim historik, restaurim, konservim dhe investim për funksionalizimin e monumenteve historike e kulturore. Natyrisht që kjo do të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës dhe të gjithë faktorët tjerë relevant. Në këtë mënyrë do të krijohen mundësi të reja jo vetëm për popullatën e komunës së Vushtrisë por edhe më gjerë, për t'u njohur me ciklin e civilizimit njerëzor në këto hapësira.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport do të zhvillohet edhe më tej në angazhimin e bashkëpunëtorëve dhe këshilltarëve të jashtëm profesional të dëshmuar në gjithë kombin.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport do të jetë e gatshme të japë kontributin e saj në çdo kohë, në të gjitha projektet komunale e shtetërore.

## KALENDARI I DATAVE NË DKRS

nr	DATA	AKTIVITETI	KULTURA	RINIA	SPORTI	
1.	?? JANAR	SPORTISTI I VITIT			SHPALLJE SOLEMNE	
2.	17 SHKURT	DITA E PAVARËSISË	Akademi solemne ( homazhe te varrezat e Dëshmorëve dhe martirëve )	Marshi i Pavarësisë	Aktivitet sportiv	
			Program artistik		Ndeshje të ndryshme sportive	
			Ekspozitë me poezi për pavarësinë ( Biblioteka )			Koncert ( AKV )
3.	5,6,7 MARS	Epopeja e UÇK-së	Program artistik			
			Homazhe në Prekaz	Koncert ( AKV )		
4.	7 MARS	Dita e Mësuesit	Program artistik			
			Koncert festiv ( në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit )	Ekspozitë me poezi ( Biblioteka )		

5.	8 MARS	Dita e Nënës	Program muzikor ( në bashkëpunim me zyrën për barazi gjinore )			Ndeshje sportive me ekipe të femrave
6.	22 MARS	Dita botërore e ujit			Aktivitet sensibilizues për kursimin e ujit	
7.	1 PRILL	Dita e ambientit			Aktivitet rinor	
			Pastrimi i parqeve dhe shtretërve të lumenjve	Sensibilizimi për mbrojtje të ambientit OJQ”Star of future”		
8.	8 PRILL	DITA E KUSHTETUTËS				
9.	18 PRILL	Dita Ndërkombëtare e Trashëgimisë	Program artistik			
			Ekspozitë ( Muzeu )	Vizitë monumenteve të trashëgimisë		
10.	22 PRILL	Dita e planetit Tokë	Ekspozitë me fotografi ose piktura ( Muzeu )		Vizitë peizazheve natyrore	
11.	27 PRILL	Dita e të pagjeturve	Program artistik			
			Ekspozitë simbolike ( Qendra e Kulturës )			
12.	9 MAJ	Dita e Evropës	Aktivitet artistik			
			Koncert me muzikë zbavitëse			
13.	?? MAJ	Dita e Martirëve	Akademi përkujtimore ( homazhe te lapidari dhe varrezat )			Turnir në shah



			Program artistik				
			Recital skenik ( Teatri )	Instrumental muzikor ( AKV )			
14.	1 QERSHOR	Dita e Fëmijëve	Program artistik				Aktivite sportive me grup-mosha të reja
			Koncert ( AKV sektori i fëmijëve në bashkëpunim me Çerdhen “ Foleja “ dhe paralelet parashkollore )	Ekspozitë me piktura dhe poezi për fëmijë ( Biblioteka )			
15.	?? QERSHOR	Takimet e Poeteshave	Program artistik				
			Pika muzikore ( AKV me bashkëpunëtor të jashtëm )	Pika skenike ( Teatri me bashkëpunëtorë të jashtëm )	Ora letrare		
16.	17 QERSHOR	DITA E ÇLIRIMIT	Program artistik			Aktivitet rinor	Aktivitet sportiv
			Koncert ( AKV )	Ekspozitë ( Muzeu )		Marshi i Pavarësisë	Turnir boxi në nivel kombëtar
17.	?? KORRIK	ME MËRGITARËT	Program artistik				
			Koncert në Qendrën e Kulturës ) ( AKV )	Koncert në ambient të jashtëm ( Grupe të ndryshme muzikore )			
	12 GUSHT	Dita ndërkombëtare e				Aktivitet rinor	

18.		rinisë		Koncert në ambient të jashtëm	Aktivitet për sensibilizim për fuqizim të rinisë	
19.	1 SHTATOR	Dita e Dëshmorëve	Akademi përkujtimore (homazhe të varrezat e Dëshmorëve)			Aktivitet sportiv
			Program artistik			
			Recital skenik (Teatri)	Instrumental muzikor (AKV)		Turnir në hendboll "TOTA"
20.	21 SHTATOR	Dita ndërkombëtare e paqes	Program artistik		Aktivitet rinor	
			Ekspozitë me foto e piktura (Qendra e Kulturës)		Marsh me pankarta me porosi për paqe	
21.	1 TETOR	DITA E PATATES	Program artistik			
			Aktivitet solemn në fshatin Pestovë	Shfaqje teatri – komedi (Teatri)		
22.	28 NËNTOR	Dita e Flamurit	Vizitë në kompleksin memorial në Prekaz		Aktivitet rinor	
			Program artistik		Marsh me flamuj kombëtar (të gjithë të veshur kuq e zi)	
			Koncert (AKV)			
23.	3 DHJETOR	Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara	Vizitë Handikos-it			
			Program artistik			
			Koncert për Handikos (Qendra e Kulturës)			
			Program artistik		Aktivitet rinor	Turnir në

24.	30 DHJETOR	VITI I RI	Koncert ( AKV )	Pika humoristike ( Teatri )	Ndezja e fishekzjarreve	futboll të vogël
-----	------------	-----------	--------------------	--------------------------------	-------------------------	------------------

1. Turniri ndërkombëtar i Ping-pongut, - shtator
2. Shfaqjet e Teatrit X2
3. Festivali i Teatrit të të Rinjve, - tetor

**Drejtori i DKRS**  
**Qamil Sahiti**

**29. 01. 201**